



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:201351  
Datë: 16.09.2024  
Numri i dokumentit: 06163556

Pml.nr.563/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës – në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurve N. M. dhe P. I., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256, paragrafi 1, lidhur me nenin 77 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe mashtrimi, nga neni 323, paragrafi 1, lidhur me nenin 77 dhe 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri – Departamenti i Përgjithshëm, PPR.nr.63/2024 të datës 14.08.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.1338/2024 të datës 23.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me pranimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve N. M. dhe P. I., ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri – Departamenti i Përgjithshëm, PPR.nr.63/2024 i datës 14.08.2024 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.1338/2024 i datës 23.08.2024, ashtu që ndaj të pandehurve ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit lëshohen për t'u mbrojtur në liri.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPR.nr.63/2024 të datës 14.08.2024, të pandehurve N. M. dhe P. I., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 dhe 31 të KPRK-së dhe mashtrimi, nga neni 323, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 dhe 31 të KPRK-së, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t'iu zgjasë nga data 15.08.2024 deri më datën 14.10.2024. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1, dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNI.nr.1338/2024 e datës 23.08.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurve N. M. avokati Fanol R. Krasniqi dhe P. I. avokati Muhamet Mehmeti, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurve t'iu ndërpritet masa e paraburgimit ose kjo masë të zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.234/2024 të datës 11.09.2024 dhe 12.09.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Mbrojtësit e të pandehurve në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë theksojnë se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, vazhdimin e paraburgimit nuk e kanë bazuar në prova të mjaftueshme dhe se me asnjë provë apo fakt konkret nuk është argumentuar dhe rrjedhimisht nuk janë plotësuar as kushtet e veçanta për vazhdimin e paraburgimit, për faktin se vetëm është theksuar se i pandehuri i parë (N. M.), ka vendqëndrim në Zvicër, ekziston rreziku u lartë që të largohet nga Republika e Kosovës dhe mos të jenë të qasshëm për organet e ndjekjes, mund të ndikojnë në dëshmitarët eventual duke mos cekur ndonjë indicie apo provë konkrete në drejtim të ndikimit dhe emrat e dëshmitarëve apo edhe mënyrën e përsëritjes së veprës penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara. Në fakt nga shkresat e lëndës rezulton dyshimi i bazuar

se të pandehurit mund të jenë kryerës të veprave penale për të cilat dyshohen, por kanë pushuari se ekzistuari bazat e artikuleshme apo bazat ligjore për të cilat i është vazhduar paraburgimi deri me tani.

Kjo Gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me neni 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ngase edhe pse i pandehuri ka vendqëndrim në Zvicër, prania e tij mund të sigurohet me anë të sekuestrimit të përkohshëm të dokumenteve të udhëtimit të të pandehurit, ftesave, bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë apo masave tjera të përshtatshme.

Po ashtu edhe sa i përket bazës ligjore të parashikuar me dispozitën e nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pika 1.2.2, të KPP-së, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës, nuk është gjetur ndonjë rrethanë konkrete e cila do të konfirmonte frikën e bazuar se të pandehurit do të do ndikojnë te dëshmitarët të cilët janë të supozuar, pasi që nuk janë cekur emrat e tyre dhe ende nuk dihet se kush mund të jenë.

Gjithashtu, edhe sa i përket bazës ligjore të parashikuar me dispozitën e nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së, duke pasur parasysh rrethanat personale të të pandehurve, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e vazhdimin të masës së paraburgimit edhe pse është theksuar fakti se i pandehuri i parë (N. M.) edhe më parë ka qenë i gjykuar për vepra penale, nuk është specifikuar dhe mbështetur në aktgjykime të cituara me numër dhe se nuk kanë dhënë ndonjë arsye konkrete tjetër përpos përshkrimit të veprimeve të të pandehurve.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj gjykate, konform nenit 438, paragrafi 1 pika 1.1, të KPP-së, aprovoi kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr. 563/2024 me datën 16.09.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala